**Marrëveshje Transferimi**

**të Pjesëve të Kapitalit të shoqërisë "FOOD PROMOTION" Sh.p.k.**

Në Tiranë, sot më 20/06/2023, palët e kësaj Marrëveshjeje ranë dakort si më poshtë:

***Shitësi:***

- **Z. Sokol Kraja,** shtetas shqiptare, lindur më **04 Qershor 1969**, në Tirane, banues në adresën: Rr. Bardhok Biba, Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. Personal **G90604128G**, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar,

- *(më poshtë referuar **"SHITËSI"**)*

*dhe*

***Bleresi:***

- **Z. Endrit Spahiu,** shtetas shqiptare, lindur më 06 Nentor 1984, në Tirane, banues në adresën: Blv. Bajram Curri, Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. Personal I41106026O, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar,

*(më poshtë referuar **"BLERËSI"**)*

**MEQËNËSE:**

A. Shitësi zotëron 100% të Kapitalit të Shoqërisë **"Food Promotion" Sh.p.k**, një shoqëri ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me **NUIS** L71914010J, me seli në: Tirane Vore PICAR Rruga Picar, Nr. 1032 ("Shoqëria"), me një kapital prej 1,000,00 Lekë, i përbërë nga 1 kuotë me vlera 1,000 Lekë.

B. Blerësi dëshiron të blejë 100% të Kapitalit të Shoqërisë të zotëruar nga Shitësi në shoqërinë e lartpërmendur **"Food promotion" Sh.p.k** siç përcaktohet në këtë marrëveshje; Shitësi transferon përkatësisht 100% të kapitalit të zotëruar në shoqëri në favor të blerësit **Z. Endrit Spahiu.**

C. Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, *"Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"*, i ndryshuar dhe nenet e Statutit të Shoqërisë, Asambleja e Ortakeve të shoqërisë ka marrë vendimin përkatës për transferimin tek Blerësit të kuotave si më sipër.

PËR SA MË SIPËR, palët bien dakort si më poshtë:

1. Shitësi pranon se ka marrë nga Blerësi në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rënë dakord në vlerën prej 1,000 Lekë (*një mijë Lekë*) dhe për këtë arsye

transferon këtu 100% të Kapitalit të zotëruar nga Shitësi në Kapitalin e Shoqërisë **"Food promotion" Sh.p.k.**, në pronësi të Blerësit.
Shitësi deklaron dhe garanton Blerësit se 100% e kapitalit që transferohet këtu është në pronësinë e tij të plotë ligjore dhe të lira nga barra, hipoteke apo pengje.

2. Blerësi pranon pronësinë e 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë, duke njohur gjendjen e Shoqërisë dhe bie dakord që përvec kufizimeve më poshte, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i këtyre Kuotave brënda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.
3. Blerësi pranon që për një periudhë 10 vjecare të gjitha vendimet që lidhen me shpërndarjen e fitimeve gjendje në datën e kësaj marrëveshje dhe që do krijohen në 10 vitet e ardhshme do të dakordohen fillimisht me Shitësin e kuotave.
4. Blerësi pranon që për një periudhë 10 vjecare nga data e nënshkrimit të kontratës, shitësi nuk mund të tjetërsojë pronësinë e kuotave pa marrë aprovimin paraprak të Shitësit.
5. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, ortakë të shoqërisë dhe pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në shoqërinë **"Food Promotion" Sh.p.k.** do të jenë:

- ***Z. Endrit Spahiu, - zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë***

6. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të këtyre Kuotave objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

Kjo Marrëveshje u hartua në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore.
Marrëveshja bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.
Marrëveshja u lexua nga palët, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre.

| **SHITËSI** | **BLERËSI** |
| --- | --- |
| **Sokol Kraja** | **Endrit Spahiu** |
| Sokol Kraja | 21/06/23 |